



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 120/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi për ankesën e Isa Turkaj në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Isa Turkaj në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 31.01.2011, nga Isa Turkaj, në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me te cilën pretendohet se gjatë procesit të numërimit të votave janë bërë padrejtësi nga vëzhguesit dhe komisionarët nëpër qendrat e votimit nëpër tërë Kosovën. Parashtruesi i ankesës konsideron se minimumi 5000 vota i janë vjedhur dhe kërkon që kjo ankesë të hasë në mirëkuptim për tu mos u detyruar që ti drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjerë në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Sipas PZAP-it pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara, nga shkakut se kërkesat e të njëjtit, të cilat i kërkon për vërtetimin se gjëja i janë vjedhur votat e theksuara në ankesë, janë të pamundura për tu realizuara për arsye se i njëjti pretendimet e tij nuk i ka bazuar në asnjë provë të vetme materiale dhe nuk ka dhënë asnjë udhëzim se ku mund të gjenden shkeljet e pretenduara në ankesë, andaj PZAP-i ankesën e të njëjtit e refuzon si të pabazuar.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 120/2011 më datën 02.02.2011

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

